



# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#96

## DIASPORA/ Miratohen tekste e unifikuara mësimore për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës shqiptare



Paketa e dokumenteve për hapjen e konkursit është miratuar dhe firmosur nga të tre ministrat përgjegjës: Ministri i Arsimit dhe Shkencës të Kosovës z. Ramë Likaj, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë znj. Evis Kushi dhe ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko.

Kjo paketë përmban dokumentet rreth procedurave të zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën, kriteret e recensuesve, si dhe shpalljen e konkursit për tekste mësimore për Diasporën hartuar nga "Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën".



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## NISMA/ "Dhuro Libra", nis procesi i shpërndarjes në Greqi dhe Itali

Është nisur sot drejt Greqisë kontingjenti i parë i librave të dhuruara kuadër të nismës "Dhuro Libra" për shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Greqi. Ditën e nesërme do të nisen kontingjenti i përcaktuar për institucionet Itali. Janë rreth 10 mijë libra të cilët janë dhuruar nga shtëpi të ndryshme botuese në vend, individë dhe institucione të ndryshme të cilat pritet të shpërndahen në burgje më datë 21 shkurt, ditën e Ndërkombëtare të Gjuhës amtare.



## Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## DHURIMI/ "Toena" pjesë e nismës "Dhuro një libër", Irena Toci: Të edukojmë përmes leximit



Shtëpia botuese "Toena" i është bashkuar nismës së Qendrës së Botimeve për Diaporën "Dhuro një libër" për shqiptarët që vuajnë dënimet në burgjet jashtë vendit.

Janë 4223 libra të dhuruara prej saj dhe Irena Toci thotë se iu bashkuan kësaj nisme duke besuar se edukimi është i rëndësishëm dhe mund të bëhet në çdo moment.




Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## LIBRAT E DHURUAR/ Ja si do të bëhet shpërndarja në burgjet në Greqi

Librat e dhuruar nga nisma e QBD-së "Dhuro një libër" do të shpërndahen më 21 shkurt, Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare në Institucionet e Vuajtjes së Dënimit në Itali dhe Greqi. Përsa i përket kësaj të fundit përmes një telekonference Ministri i Shtetit për Diasporën. Pandeli Majko, Ambasadorja shqiptare në Athinë Luella Hajdaraga, Konsujt e Përgjithshëm të Shqipërisë në Selanik e Janinë, Arqile Sota dhe Eltjon Verleni, Drejtoresha e Kabinetit të Ministratit të Shtetit për Diasporën, Ada Ilia dhe Oficeret Koordinuese për Diasporën në Athinë e Selanik, Joneda Dodaj dhe Aurela Konduri.

Aktualisht janë grumbulluar rreth 10 mijë libra të cilët janë dhuruar nga shtëpi të ndryshme botuese në vend, individë dhe institucione të ndryshme, të cilët do të shpërndahen në qendrat e sipërpërmendura në datën 21 shkurt, Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, për ti dhënë mundësinë qindra shtetasve shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë të lexojnë në gjuhën shqipe.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## VENDIMI/ Ngrihet grupi i punës së Koordinatorëve për Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën



Me vendim të Këshillit të Ministrave është ngritur grupi i koordinatorëve për Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025. Ky grup është përgjegjës për bashkërendimin e punës për zbatimin e masave të Planit të Veprimit në institucionin, të cilin përfaqësojnë. Ka për detyrë ndjekjen dhe zbatimin e masave të përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025, si dhe përcaktimin e detajimit e kostove dhe të indikatorëve për të gjitha masat e parashikuara në planin e veprimit.

Grupi kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje ka zëvendësministrat si edhe dy ekspertë të fushës në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, arsimin, financat, turizmin, punët e brendshme, drejtësinë, shëndetësinë, bujqësinë, kulturën; përfaqësues të ministratit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Akademisë së Shkencave; dhe titullarët e INSTAT-it, AKSHI-t dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: këtu Play store: këtu

## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## Dhuro Libra



Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

**Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni  
[www.diasporashqiptare.al](http://www.diasporashqiptare.al)**